ALBANIAN UNIVERSITY

*UNIVERSITAS – FABREFACTA - OPTIME*

# RAPORT VJETOR

# Viti Akademik 2016 - 2017

# Përmbajtja


## Hyrje

1. **Programet e studimit**

- Programet e studimit të zhvilluara gjatë vitit dhe ecuria e tyre;
- Programet aktiv dhe jo aktiv;
- Programet që janë akredituar gjatë vitit ose jo, ato që duhet të ri/akreditohen në vitin e ardhshëm.
- Rishikimi i kurrikulave të programeve të studimit, ndryshimet e realizuara dhe arsyet
- Rishikimi dhe miratimi i rregulloreve për çdo program studimi sipas Ligjit të Ri të Arsimit të Lartë

2. **Stafi akademik**

- Rekrutimi i stafit akademik për vitin akademik 2016-2017, nevojat për staf për vitin 2017-2018
- Puna e pedagogëve e matur përmes raportit të vetëvlerësimit
- Puna e pedagogëve e matur përmes pyetësorëve të studentëve
- Puna e pedagogëve e matur nga drejtuesi i departamentit

3. **Mësimdhënia dhe Studentët**

- Informimi i studentëve
- Zbatimi i kalendarit akademik, mbështetur në relacionet e pedagogëve për lëndën e tyre
- Sigurimi i leksioneve dhe teksteve universitare në hardcopy dhe në rrugë elektronike, etj.
- Kalueshmëria dhe nota mesatare e rezultateve të tyre për çdo program studimi

4. **Infrastruktura**

- Mjediset ku zhvillohen leksionet, praktikat, salla e kompjuterëve, laboratorët, etj.
- Biblioteka, gjendja aktuale, pasurimi me tekste të reja, nevojat për vitin e ardhshëm

5. **Financimi**

- Financimi i veprimtarive shkencore dhe kualifikimeve të stafit

6. **Kërkimi shkencor**

- Veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit nga departamenti si: konferenca, workshop, tryeza të rrumbullakëta, leksione të hapura, etj.

- Veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit nga pedagogët si: konferenca, projekte, publikime, etj.
- Veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit nga studentët si: konferenca studentore, aktivitete ekstrakurrikulare, etj.

## 7. Bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit

- Marrëveshjet e firmosura me partner të ndryshëm si dhe për çfarë i shërbejnë Universitetit

## 8. Aplikimi në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare

## 9. Analiza SWOT

## HYRJE

**A**lbanian University është një institucion privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë, i cili është licencuar në prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe është akredituar me Vendim nr. 90 datë 20.10.2017 të Bordit të Akreditimit.

**R**aporti i vlerësimit të brendshëm institucional për vitin akademik 2016-2017 shqyrton veprimtarinë e aktorëve kryesorë të AU duke u fokusuar në misionin dhe objektivat, stafin akademik, kurrikulën, politikat e formimit të studentëve, politikat e kërkimit shkencor, zhvillimin e karrierës, strategjitë e zhvillimit, etj. Raporti përmbledh përshkrimet analitike të situatës, treguesit e matshëm, dhe vlerësimin sipas standardeve për kategoritë e përcaktuara në udhëzuesin e vlerësimit të brendshëm, përfundimet e arritura, si dhe rekomandime lidhur me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, ngritjen e strukturave dhe nivelit të kërkimit shkencor në vitet e ardhshme.

## VIZIONI, MISIONI DHE ZHVILLIMI STRATEGJIK I AU

**Vizioni** i "AU" si një institucion arsimor i nivelit të lartë, i njohur për kompetencën e të diplomuarve të saj, për programet e saj të forta dhe orientimin ndërdisiplinor është që të shndërrohet në një Institucion i Arsimit të Lartë që ofron një gamë të gjerë programesh të ndërkombëtarizuara. Synimi i këtij institucioni është ndikimi në shoqëri përmes iniciativave arsimore, kërkimore shkencore, ekonomike, intelektuale dhe kulturore.
"AU" pretendon të zhvillojë një proces mësimor e kërkimor emocionues dhe sfidues, duke përdorur metoda bashkëkohore, me infrastrukturë të arrirë: bibliotekë cilësore, laboratorë të mjaftueshëm, teknologji bashkëkohore, mjedise të sigurta e të bukura.
"AU" punon që të arrijë standardet e kërkuara përmes vetëvlerësimit të vazhdueshëm e rigoroz duke e matur suksesin me treguesit e besueshëm të përfitimeve për studentët në aspektin etik, shkencor e profesional që do të garantojë përgatitjen e tyre si qytetarë të denjë e me besim në drejtim të suksesit ekonomik dhe të një jete cilësore.

"AU" ka si objektiv gjithashtu që pjesëtarët e komunitetit të saj të gjejnë në këtë institucion stimulin e nevojshëm intelektual dhe kulturor, duke qenë nga të gjitha krahinat e vendit e më gjerë, nga të gjitha kategoritë shoqërore dhe moshore, por të angazhuar në botën e ideve.

**Misioni** i "Albanian University" është të sigurojë arsimim cilësor universitar dhe pasuniversitar dhe të ofrojë përgatitje profesionale të rendit të parë në edukim, në shkencat mjekësore, në shkencat e aplikuara inxhinierike dhe ekonomike, në shkenca sociale dhe juridike, në mësuesi dhe administrim publik, etj.

"AU" ofron përgatitje dhe diplomim të studentëve për një spektër të gjerë njohurish, të domosdoshme për zhvillimin e karrierës së ardhme, dhe që krijon mundësi për nxitjen e pasionit për rinovim njohurish përmes të mësuarit gjatë gjithë jetës. Studentët në këtë institucion përgatiten për një botë në ndryshim, si kontribuues përmes dijeve dhe përmes shërbimit.

Duke ndjekur zhvillimet arsimore, shkencore, ekonomike e shoqërore në vend dhe jashtë tij, “AU” është i angazhuar për respektimin dhe ruajtjen e vlerave që lidhen me diversitetin e elementëve etnik, social dhe kurrikular duke pasqyruar një vetëdije globale. Kështu, “AU” mbetet i hapur për të rekrutuar studentë të kategorive të ndryshme shoqërore dhe nacionale duke bërë kujdes që të mbetet i angazhuar për të përsosur procesin mësimor, kërkimin shkencor, edukimin qytetar e kulturor, në funksion të ofrimit të një shërbimi publik për të gjithë, në një shoqëri të hapur.

“AU” beson në përgatitjen dhe zhvillimin e gjithanshëm të studentëve, si kolona të nevojshme për të shërbyer në shoqëri si qytetarë të shkolluar dhe të kualifikuar. Duke vlerësuar e zbatuar eksperienca të traditës për mësimdhënie dhe kërkim shkencor, “AU” mbështet dhe nxit rrugë e metoda të reja për zhvillimin profesional e kulturor të studentëve. Për këtë qëllim, krijohen mundësi të shumta edhe në bashkëpunim me Këshillin Studentor për praktika mësimore, programe kulturore dhe artistike, si dhe për pjesëmarrje në veprimtari çlodhëse e të dobishme për publikun dhe në shërbim të komunitetit.

Të udhëhequr nga vlerat dhe të përqendruar te njerëzit, ky institucion synon të përdorë njohuritë që transmeton tek studentët për të ndryshuar të ardhmen e jetës së tyre, duke kontribuar kështu për një shoqëri produktive dhe të begatë.

Për përmbushjen e misionit të tij, institucioni ofron një ofertë akademike elastike dhe të mbështetur nga epërsia në mësimdhënie dhe mësim nxënie, duke krijuar një pjesëmarrje aktive të studentëve, kërkim shkencor të zbatuar me njohje dhe ndikim brenda vendit, bashkëpunim me biznesin dhe sipërmarrjet, duke luajtur një rol kyç në zhvillimin e rrjeteve që mbështesin lidhjet ndërkombëtare përmes partnerëve dhe bashkëpunëtorëve tanë.

“AU” ka hartuar strategjinë e zhvillimit institucional me objektiva të përcaktuara qartë afatshkurtër dhe afatgjatë për përmbushjen efektive të tyre në përputhje me vizionin dhe misionin e tij. Strategjia përfshin gjerësisht ndjekjen e orientimeve kryesore me rëndësi për sukses në të ardhmen.

“AU” përfaqëson një nga alternativat serioze, të besueshme, profesionale dhe konkurruese në rrjedhën e zhvillimeve të shumta të Arsimit të Lartë që synon të ofrojë standarde, cilësi, përgatitje bashkëkohore dhe përshtatje me tregun e punës.

“AU” është i orientuar drejt vlerave dhe formave të reja të kërkim-zhvillimit, duke synuar të formojë specialist të zot që marrin përsipër e u përgjigjen me dinjitet sfidave të të jetuarit në një shoqëri të hapur.

Misioni i “Albanian University” është zhvillimi dhe zgjerimi i kufijve të njohjes përmes arsimit më të mirë, rritjes intelektuale, sociale e kulturore të studentëve, duke kontribuar në dobi të komunitetit me aspiratën e një mjedisi intelektual që nxit mendimin kritik, krijues, me vlera, parime dhe etikë akademike institucionale. Si një universitet privat por me një mision të rëndësishëm publik, “AU” stimulon studentët në zhvillimin e hulumtimeve dhe reflektimeve për çështjet e rëndësishme të komunitetit kombëtarë dhe ndërkombëtarë, nëpërmjet një arsimimi cilësor dhe programeve moderne të studimit.

Në vazhdim të misionit tonë qëndron ridimensionimi i arsimit universitar, rritja e programeve kërkimore, nxitja e klimës së respektit të ndërsjellët tek studentët, mbështetje në zhvillimin e ideve të tyre në shërbim të kombit dhe të shtetit, me qëllimin primar përsosmërinë e universitetit dhe bërjen e tij kompetitiv në tregun e punës. Misioni është nxjerrja e një produkti sa më kompatibël me tregun, në arritjen e targetit themelor: "Produktit që përparon në tregun e punës, profesionistit"! Në hierarkinë e vlerave të "AU", qëndron dimensioni human dhe vullnetarizmi, që përkthehet në përparësinë e vullnetit mbi intelektin dhe veprimit në mendimin intelektual, nëpërmjet një aktiviteti të përbashkët dhe punë të frytshme vullnetare që nxit të mirën e përgjithshme. "AU" si vlerë, por edhe materialisht, u përket studentëve, pedagogëve, punonjësve dhe të gjithë atyre që kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj nisme. Objektivat tona janë ambicioze e afatgjata, e bazuar në akreditimin e programeve dhe Statutin e "AU", synojmë të sigurojmë rritje cilësore në përgatitjen e brezave për t'ju përgjigjur ekonomisë së tregut, duke synuar të jemi gjithmonë një qendër e fuqishme e arsimit jo publik në vend.

***Vlerat tek të cilat besojmë:***

• Cilësia në çdo iniciativë akademike;
• Integriteti dhe korrektësia organizative;
• Kolegjialiteti dhe pjesëmarrja në vendimmarrje;
• Vullnetarizmi dhe përgjegjshmëria në arritjen e standardeve arsimore;
• Përgjegjshmëri dhe liri akademike;
• Ruajtja e etikës dhe krijimi i besueshmërisë.

"AU" ka si kolona të forta për besim dhe sukses orientimin drejt Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, profesionalizmin e përkushtimin e shkallës së lartë, bashkëpunimin e vazhdueshëm e të pandërprerë me studentët dhe faktorët e tjerë që motivojnë dhe nxisin progres.

"AU" krijon mundësi të mëdha për arritjen e potencialeve të plota fizike, intelektuale, emocionale, sociale dhe shpirtërore që nevojiten në një botë pa kufij.

**Përparësi të "Albanian University"**

Disa nga përparësitë e "AU" janë:

- Numri i madh i programeve të studimit që ofron në ciklin e parë (Bachelor), tërësisht për profesione të kërkuara e me shumë mundësi punësimi;
- Standardet e larta akademike të evidentuara me përqindjen e lartë të stafit me tituj e grada shkencore;
- Besueshmëria publike e institucionale e lartë;
- Pajtueshmëria në rritje me kurrikulat e programet e përparuara në vend, në rajon e më gjerë;
- Treguesit infrastrukturorë e laboratorikë sipas standardeve të kërkuara;

1. **Programet e studimit**

- Programet e studimit të zhvilluara gjatë vitit dhe ecuria e tyre,
- Programet aktiv dhe jo aktiv,
- Programet që janë akredituar gjatë vitit ose jo, ato që duhet të ri/akreditohen në vitin e ardhshëm.
- Rishikimi i kurrikulave, ndryshimet e realizuara dhe arsyet
- Rishikimi dhe miratimi i rregulloreve për çdo program studimi sipas Ligjit të Ri të Arsimit të Lartë

Viti akademik 2016-2017 shënon një vit të rëndësishëm për Albanian University, pasi në këtë vit akademik konkretisht në datat 18 dhe 19 Maj 2017 Universiteti priti për herë të parë vlerësuesit e jashtëm në kuadër të akreditimin institucional, vizitë kjo që u konkludua me sukses pas një punë të kënaqshme mundësuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm dhe të gjitha strukturat institucionale. Në përfundim të këtij procesi Albanian University është njohur me Vendimin e Bordit të Akreditimit dhe është pajisur me certifikatën e Akreditimin me një afat vlefshmërie deri në periudhën 20.10.2019. Përveç kësaj, kanë kaluar procesin e akreditimit me rezultate pozitive një sërë programesh studimi të ciklit të parë dhe të dytë. Në vazhdimësi, programet e studimit u nënshtrohen proceseve të Riakreditimit bazuar në afatet kohore të vlefshmërisë së tyre të përcaktuara në Vendimet e Bordit të Akreditimit.

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKESORE**<br>**DEPARTAMENTI I INFERMIERISE DHE FIZIOTERAPISE** | | | | | | | |
| Bsc. Infermieri | Aktiv | Urdhër Nr. 239, datë 09.05.2016 ** | 09.11.2016 | Jo | | - | |
| | | Vendim BA nr. 31, dt. 19.05.2017 | 31.07.2019 | | | | |
| Bsc. Fizioterapi | Aktiv | Urdhër Nr. 238, datë 09.05.2016 ** | 09.11.2016 | Jo | | - | |
| | | Vendim BA nr. 30, dt. 19.05.2017 | 31.07.2019 | | | | |
| Mp. Infermieri Kirurgjikale | Aktiv | Urdhër Nr. 242, datë 09.05.2016 ** | 09.11.2016 | Po | Prof.Dr Vera Ostreni;<br>Akademik. Anesti Kondili;<br>Prof.Asc.Tefta Rota;<br>Dr.Marsida Duli | Nr.37/2 Prot.<br>Dt. 03.02.2017 | Ndryshimi i Ligjit të Arsimit të lartë. |
| | | Vendim BA nr. 32, dt. 19.05.2017 | 30.09.2018 | | | | |
| **DEPARTAMENTI I FARMACISE** | | | | | | | |
| Msc. Farmaci | Aktiv | Urdhër nr. 462, dt. 14.10.2010 | 14.10.2016 | Po | Prof.As Aida Dama,<br>Dr. Kleva Shpati,<br>Msc. Aurora Napuce | *Vendim Nr.6, Nr.494/2 Prot.*<br>*Dt.07.12.2015* | Qëllimi i ndryshimit të kurrikulës është bëre për uniformizimin e kurrikulës së masterit shkencor në Farmaci në mënyrë të tillë që ky i fundit të lejojë mobilitetin |
| | | Riakreditimi ne pritje te daljes se VBA | | | | | |

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | e studentëve dhe përshtatjen me tregun e punës. |
| Dr. Shkenca Farmaceutike | Jo aktiv | VKA nr. 214 dt.16.12.2016 | Vendim negativ | Jo | | | |
| **DEPARTAMENTI I STOMATOLOGJISE** | | | | | | | |
| Msc. Stomatologji | Aktiv | Urdhër nr. 388, dt. 23.07.2010 & Urdhër nr. 445, dt. 01.10.2010 | 23.07.2016 | Jo | | | |
| | | Vendim BA nr. 88, dt. 21.09.2017 | 30.09.2022 | | | | |
| SPA Kirurgji (Orale) | Aktiv | Vendim nr.27, dt. 19.05.2017 | Vetëm për brezat e regjistruar përpara vitit akademik 2013-2014. | Po | Akademik Anesti Kondili, Prof.Dr. Vera Ostreni, Prof. Claudio Taglia, Dr. Erda Qorri | Nr.179/4 Prot. Dt. 29.05.2017 | Ndryshimi i Ligjit të Arsimit të lartë dhe Standardeve Shtetërore të Cilësisë. |
| SPA Kirurgji OMF | Aktiv | Vendim nr.28, dt. 19.05.2017 | Vetëm për brezat e regjistruar përpara vitit akademik 2013-2014. | Po | | | |
| Spa.Implantologji | Aktiv | Vendim BA nr. 26, dt. 19.05.2017 | Vetëm për studentët e regjistruar para vitit akademik 2013-2014 | Po | | | |
| Spa. Orthodonci | Aktiv | Vendim BA nr. 29, dt. 19.05.2017 | Vetëm për studentët e regjistruar para vitit akademik 2013- | Po | Akademik Anesti Kondili, Prof.Dr. Vera Ostreni, | Nr.179/4 Prot. Dt. 29.05.2017 | Ndryshimi i Ligjit të Arsimit të lartë dhe Standardeve Shtetërore të |

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2014 | | Prof. Giovani Gravina Manes,<br>Dr. Erda Qorri | | Cilësisë. |
| Spa.Endodonti | Jo Aktiv | | | | | | |
| Spa. Dentistri Pediatrike | Jo Aktiv | | | | | | |
| Spa. Periodontologji | Jo Aktiv | | | | | | |
| Spa. Prosthodonti | Jo Aktiv | | | | | | |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE TE APLIKUARA DHE EKONOMIKE**<br>**DEPARTAMENTI I ARKITEKTURES** | | | | | | | |
| Bsc. Dizajn | Aktiv | Urdhër nr. 439, dt. 25.08.2016** | 25.02.2017 | Jo | n/a | n/a | |
| | | Vendim BA nr. 74, dt. 21.09.2017 | 30.09.2019 | | | | |
| Msc. Arkitekturë | Aktiv | Urdhër nr. 388, dt. 23.07.2010 & Urdhër nr. 445, dt. 01.10.2010 | 23.07.2016 | Jo | n/a | n/a | |
| | | Riakreditimi ne pritje te daljes se VBA | | | | | |
| Dr. Arkitekturë | Jo aktiv | | | | | | |
| **DEPARTAMENTI I INXHINIERIVE** | | | | | | | |
| Bsc. Teknologji | Aktiv | Vendim BA nr. 43, dt. 19.05.2017 | 18.11.2017 (Në | Po | Dr. Sonila Daiu<br>Dr. Romeo Teneqexhi | Vendimi i Senatit **dt.** | |

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Informacioni | | | proces Riakreditimi) | | MSc. Katerina Dhoska<br>Dr. Adisa Dabërdini<br>Dr. Luçiana Toti<br>Msc. Robert Kodra<br>MSc. Sidita Çoniku | **15.09.2017** | |
| Bsc. Inxhinieri Elektrike | Aktiv | Vendim BA nr. 40, dt. 19.05.2017 | 18.11.2017 (Në proces Riakreditimi) | Po | Dr. Sonila Daiu<br>Dr. Romeo Teneqexhi<br>MSc. Katerina Dhoska<br>Dr. Fatmir Basholli<br>MSc. Burhan Çanga<br>MSc. Sidita Çoniku | Vendimi i Senatit **dt. 15.09.2017** | |
| Bsc. Inxhinieri Elektronike | Aktiv | Vendim BA nr. 41, dt. 19.05.2017 | 18.11.2017 (Në proces Riakreditimi) | Po | Dr. Sonila Daiu<br>Dr. Romeo Teneqexhi<br>MSc. Katerina Dhoska<br>Dr. Adisa Dabërdini<br>Dr. Luçiana Toti<br>MSc. Robert Kodra<br>MSc. Sidita Çoniku | Vendimi i Senatit **dt. 15.09.2017** | |
| Bsc. Inxhinieri Mekatronike | Aktiv | Urdhër nr. 436, dt. 25.08.2016** | 25.02.2017 | Po | Prof. Dr. Petraq Marango<br>Prof. Asoc. Dr. Agim Anxhaku<br>Dr. Fatmir Basholli<br>Dr. Klodian Dhoska | Vendimi i Senatit **Nr. 301/2 dt. 04.11.2016** | |
| | | Vendim BA 51, dt. 10.07.2017 | 31.07.2020 (3 vite) | | Prof. Asoc. Dr. Agim Anxhaku<br>Dr. Sonila Daiu<br>Dr. Romeo Teneqexhi<br>MSc. Katerina Dhoska<br>MSc. Sidita Çoniku | Vendimi i Senatit **dt. 15.09.2017** | |

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Bsc. Inxhinieri Kompjuterike | Aktiv | Vendim BA nr. 42, dt. 19.05.2017 | 18.11.2017<br>(Në proces Riakreditimi) | Po | Prof. Asoc. Dr. Igli Tafa<br>Dr. Sonila Daiu<br>Dr. Romeo Teneqexhi<br>MSc. Katerina Dhoska<br>Dr. Adisa Dabërdini<br>Dr. Luçiana Toti<br>MSc. Robert Kodra<br>MSc. Sidita Çoniku | Vendimi i Senatit **dt. 15.09.2017** | |
| Msc. Teknologji Informacioni | Aktiv | Urdhër nr. 383, dt. 8.07.2016** | 30.09.2016 | Po | Dr. Adisa Dabërdini | Vendimi i Senatit **dt. 15.09.2017** | |
| | | Vendim BA nr. 37, dt. 19.05.2017 | 31.07.2018 | | | | |
| Msc. Inxhinieri Elektronike | Aktiv | Urdhër nr. 380, dt. 8.07.2016** | 30.09.2016 | Po | Prof. Asoc. Dr. Bexhet Kamo<br>Dr. Desar Shahu<br>Dr. Adisa Dabërdini | Vendimi i Senatit **dt. 15.09.2017** | |
| | | Vendim BA nr. 36, dt. 19.05.2017 | 31.07.2018 | | | | |
| Msc. Inxhinieri Mekatronike | Aktiv | Vendim BA nr. 59, dt. 10.07.2017 | Vendim negativ | Jo | | | |
| Msc. Inxhinieri Kompjuterike | Aktiv | Vendim BA nr. 58, dt. 10.07.2017 | Vetëm për studentët e regjistruar në vitin 2016-2017 dhe që aktualisht ndjekin studimet | Jo | | | |
| **DEPARTAMENTI I SHKENCAVE EKONOMIKE** | | | | | | | |
| Bsc. Financë - Bankë | Aktiv | Urdhër nr. 355, dt. 03.11.2009 | 03.11.2010 | Jo | n/a | n/a | |
| | | Urdhër nr. 541, dt. 01.12.2010 | 01.12.2106 | | | | |

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Vendim Bordi Akreditimi nr. 85, dt. 21.09.2017 | 30.09.2019 | | | | |
| Bsc. Menaxhim Biznesi | Aktiv | Urdhër Nr. 240, datë 09.05.2016** | 09.11.2016 | Jo | n/a | n/a | |
| | | Vendim BA nr. 33, dt. 19.05.2017 | 31.07.2018 | | | | |
| Mp. Menaxhim Bankar dhe Financiar | Aktiv | Urdhër Nr. 441, datë 25.08.2016** | 25.02.2017 | Po | 1.Prof.Dr.Agron Tato, 2.Prof.Asoc.Remzi Sulo, 3.Prof.Asoc.Setki Mulla, 4.Prof.Asoc.Eda Bezhani, 5.Prof.Asoc.Etleva Dashi, 6.Prof.Asoc.Stavri Sinjari, 7.Dr.Aurel Koroci | Vendim Senati nr. 16, Dt. 24.05.2017 | |
| | | Vendim BA nr. 53, dt. 10.07.2017 | Vetëm për studentët e regjistruar nga viti 2011-2012 deri në 2016-2017 dhe që aktualisht ndjekin studimet | | | | |
| Mp. Administrim Biznesi | Aktiv | Urdhër Nr. 440, datë 25.08.2016** | 25.02.2017 | Po | | Vendim Senati nr. 16, Dt. 24.05.2017 | |
| | | Vendim BA nr. 52, dt. 10.07.2017 | Vetëm për studentët e regjistruar nga viti 2011-2012 deri në 2016-2017 dhe që aktualisht ndjekin studimet | | | | |
| Mp. Menaxhim shëndetësor | Jo aktiv | | | | | | |
| Msc. Menaxhim Bankar | Aktiv | Urdhër nr. 327, dt. 07.08.2012 | 07.08.2018 | Jo | n/a | n/a | |

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Msc. Administrim Biznesi | Aktiv | Urdhër nr. 327, dt. 7.08.2012 | 07.08.2018 | Jo | n/a | n/a | |
| Dr. Financë | Jo aktiv | | | | | | |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQERORE**<br>**DEPARTAMENTI I SHKENCAVE JURIDIKE** | | | | | | | |
| Bsc. Shkenca Juridike | Aktiv | Urdhër nr. 355, dt. 03.11.2009 | 03.11.2010 | Po* | Dr. Elona Doko<br>Dr. Renata Tokrri<br>Ma. Dhurata Islambejo | *Në pritje të zyrtarizimit të kurrrikulës së re nga MASR, Diplomë e Nivelit të Dytë e Integruar në Drejtësi | Përshtatja me ndryshime të Ligjit Nr. 80/2015 |
| | | Urdhër nr. 541, dt. 1.12.2010 | 01.12.2016 | | | | |
| | | Vendim BA nr. 87, dt. 21.09.2017<br>Vendim BA nr. 87/1, dt. 20.10.2017 | 30.09.2020 | | | | |
| Mp. Shkenca Penale | Aktiv | Urdhër nr. 585, dt. 27.11.2012 | 27.11.2008 | Po | Dr. Elona Doko<br>Dr. Renata Tokrri<br>Ma. Dhurata Islambejo | Vendim Senati Nr 16, datë 24.05.2017 | Përshtatja me ndryshimet e Ligjit Nr. 80/2015 |
| Mp. E Drejtë Private | Aktiv | Urdhër nr. 585, dt. 27.11.2012 | 27.11.2008 | Po | Dr. Elona Doko<br>Dr. Renata Tokrri<br>Ma. Dhurata Islambejo | Vendim Senati Nr 16, datë 24.05.2017 | Përshtatja me ndryshimet e Ligjit Nr. 80/2015 |
| Msc. Shkenca Juridike (5 profile) | Aktiv * | Vendim BA nr. 49, dt. 19.05.2017<br>*(Jo aktiv profili Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe E Drejtë Ndërkombëtare dhe Bashkimi | 31.07.2019 | Jo | - | - | - |

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Evropian) | | | | | |
| Dr. E Drejtë dhe Procedurë Penale | Jo Aktiv | | | | | | |
| Dr. E Drejtë Europiane dhe e Kontratave | Jo Aktiv | nr.213 dt.16.12.2016 | Vendim negativ | Jo | - | - | - |
| **DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISE SE PERGJITHSHME** | | | | | | | |
| Bsc. Psikologji e Përgjithshme | Aktiv | Urdhër nr. 541, dt. 01.12.2010 | 01.12.2016 | Jo | | | |
| | | Vendim BA nr. 84, dt. 21.09.2017 | 30.09.2020 (3 vite) | | | | |
| Mp. Psikologji Shkollore | Aktiv | Vendim BA nr. 44, dt. 19.05.2017 | Per studentet e regjistruar nga viti 2013-2014 deri ne vitin 2016-2017 dhe qe aktualisht ndjekin studimet<br><br>30.09.2018 | po | | po | Përshtatja me ndryshimet e Ligjit Nr. 80/2015<br><br>Nga 90 në 60 ECTS |
| Mp. Psikologji Klinike | Aktiv | Urdhër nr. 327, dt. 07.08. 2012 | 07.08.2018 | Po | | Po | Përshtatja me ndryshimet e Ligjit Nr. 80/2015<br><br>Nga 90 në 60 ECTS |
| Msc. Psikologji | Jo | Vendim BA nr. 48, dt. 19.05.2017 | 31.07.2019 | Jo | | | |

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zhvillimi dhe Shkollore | aktiv | | | | | | |
| Msc. Psikologji Klinike | Aktiv | Urdhër Nr. 327, datë 07.08.2012 | 07.08.2017 | Jo | | | |
| Msc. Psikologji Ligjore | Aktiv | Vendim BA nr. 47, dt. 19.05.2017 | 31.07.2019 | Jo | | | |
| Msc. Këshillim Psikologjik | Jo aktiv | Vendim BA nr. 46, dt. 19.05.2017 | 31.07.2019 | Jo | | | |
| Dr. Psikologji Klinike | Jo Aktiv | BA nr. 14, dt. 19.05.2017 | Vendim negativ | Jo | | | |
| **DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKO-ADMINISTRATIVE** | | | | | | | |
| Bsc. Shkenca Politiko -Administrative | Aktiv | Urdhër nr. 532, dt. 27.11.2010 | 27.11.2016 | Jo | | | |
| | | Vendim BA nr. 86, dt. 21.09.2017 | 30.09.2019 (2 vite) | | | | |
| Mp. Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci | Jo aktiv | Urdhër nr. 585, dt. 27.11.2012 | 27.11.2018 | Po | PAE | Po | Në zbatim të ligjit nr. 80/2015"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL.<br><br>Nga 90 në 60 ECTS |
| Mp. Qeverisje dhe | Aktiv | Urdhër nr. 499, dt. 18.10.2012 | 18.10.2018 | Po | PAE | Po | Në zbatim të ligjit nr. 80/2015"Për |

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Administrim Publik | | | | | | | Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL.<br>Nga 90 në 60 ECTS |
| Mp. Studime mbi Sigurinë | Jo aktiv | Vendim BA nr. 45, dt. 19.05.2017 | Vetem per studentet e regjistruar ne vitet akademike 2010-2011 dhe 2011-2012 | Po | PAE | Po | Në zbatim të ligjit nr. 80/2015"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL.<br>Nga 90 në 60 ECTS |
| Msc. Marrëdhënie Ndërkombëtare (me 2 profile) | Jo aktiv | Urdhër nr. 499, dt. 18.10.2012 | 18.10.2018 | Jo | | | |
| Msc. Administrim Publik (me 2 profile) | | Urdhër nr. 499, dt. 18.10.2012 | 18.10.2018 | Jo | | | |
| Dr. Marrëdhënie Ndërkombëtare | Jo Aktiv | | | | | | |
| Dr. Shkenca Administrative | Jo Aktiv | nr. 212 dt.16.12.2016 | Vendim negativ | Jo | | | |
| **DEPARTAMENTI I EDUKIMIT DHE ANGLISHTES** | | | | | | | |
| Bsc. Mësuesi për Arsimin Fillor | Aktiv | Urdhër nr. 381, dt. 8.07.2016** | 09.11.2016 | Po | Prof.Asoc.Dr. Sotir Rrapo | Vendim nr. 19/1 Dt.02.12.2016 | Kusht i vendosur nga Vlerësuesit e Jashtëm, ASCAL |
| | | Vendim BA nr. 34, dt. 19.05.2017 | 31.07.2019 | | | | |

| Programi i studimit | Gjendja | Urdhër/Vendim i akreditimit | Vlefshmëria e akreditimit | Rishikimi kurrikulës | Grupi i punës | Ndryshimi i kurrikulës | Arsyeja e ndryshimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Dr. Ndricim Mehmeti<br>Dr. Bledar Kurti | | |
| Bsc. Mësuesi për Arsimin Parashkollor | Aktiv | Urdhër Nr. 241, datë 09.05.2016** | 09.11.2016 | Po | Prof.Asoc.Dr. Sotir Rrapo<br>Dr. Ndricim Mehmeti<br>Dr. Bledar Kurti | Vendim nr. 19/1 Dt.02.12.2016 | Kusht i vendosur nga Vlerësuesit e Jashtëm, ASCAL |
| | | Vendim BA nr. 35, dt. 19.05.2017 | 31.07.2019 | | | | |
| Bsc. Anglisht | Aktiv | Urdhër nr. 437, dt. 25.08.2016** | 25.02.2017 | Jo | | | |
| | | Vendim BA nr. 50, dt. 10.07.2017 | 31.07.2020 | | | | |
| Mp. Pedagogji me profil "Didaktikë" dhe "Menaxim Arsimi" | Aktiv | Urdhër Nr. 29, datë 31.01.2013 | 31.01.2019 | Po | Prof.Asoc.Dr. Sotir Rrapo<br>Dr. Ndricim Mehmeti<br>Dr. Bledar Kurti | Vendimin Nr. 15,<br>Dt. 24.05.2017 | Riorganizimi i programit të studimit sipas ligjit të ri për arsimin e lartë 80/2015 |
| Msc. Mësuesi për Arsimin Fillor | Aktiv | Vendim BA nr. 55, dt. 10.07.2017 | Vetëm për studentët e regjistruar në vitin 2016-2017 | Jo | | | |

**** - Akreditimi me kusht**

**RISHIKIMI I RREGULLOREVE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

| Nr. | Programi i studimit | Rishikimi i rregullores gjate 2016-2017 | Data e miratimit |
|---|---|---|---|
| **FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKESORE**<br>**Departamenti i Infermierisë Dhe Fizioterapisë** | | | |
| 1 | Bsc. Infermieri | Po | Vendim Këshilli Fakulteti nr.233/1, Dt. 12.10.2016 |
| 2 | Bsc. Fizioterapi | Po | Vendim Këshilli Fakulteti nr.233/1, Dt. 12.10.2016 |
| 3 | MP. Infermieri Kirurgjikale | Po | Vendim Këshilli Fakulteti nr.233/1, Dt. 12.10.2016 |
| **Departamenti i Farmacisë** | | | |
| 1 | Msc. Farmaci | Po | Vendim Nr. 11, Dt. 12.10.2016 |
| **Departamenti i Stomatologjisë** | | | |
| 1 | Msc. Stomatologji | **Jo** | |
| 2 | SPA Kirurgji Orale | Po | Vendim Senati Nr. 16, Nr.228/1 Prot, Dt. 29.06.2017 |
| 3 | SPA Kirurgji OMF | Po | Vendim Senati Nr. 16, Nr.228/1 Prot, Dt. 29.06.2017 |
| 4 | Spa.Implantologji | Po | Vendim Senati Nr. 16, Nr.228/1 Prot, Dt. 29.06.2017 |
| 5 | Spa. Orthodonci | Po | Vendim Senati Nr. 16, Nr.228/1 Prot, Dt. 29.06.2017 |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE TE APLIKUARA DHE EKONOMIKE**<br>**Departamenti i Shkencave Ekonomike** | | | |
| 1. | Bachelor në Financë-Bankë | Jo | |
| 2. | Bachelor në Menaxhim Biznesi | Jo | |
| 3. | MP në Menaxhim Bankar dhe Financiar | U rishikua në përshtatje me LAL 80/2015 | Vendim Senati nr. 16, datë 24.05.2017 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4. | MP në Administrim Biznesi | U rishikua në përshtatje me LAL 80/2015 | Vendim Senati nr. 16, datë 24.05.2017 |
| 5. | MSc. në Menaxhim Bankar | Jo | |
| 6. | MSc. në Administrim Biznesi | Jo | |
| **Departamenti i Inxhinierive** | | | |
| 1 | Ba. Inxhinieri Elektronike | U rishikua në përshtatje me LAL 80/2015 | Vendim Senati datë 15.09.2017 |
| 2 | Ba. Teknologji Informacioni | U rishikua në përshtatje me LAL 80/2015 | Vendim Senati datë 15.09.2017 |
| 3 | Ba. Inxhinieri Kompjuterike | U rishikua në përshtatje me LAL 80/2015 | Vendim Senati datë 15.09.2017 |
| 4 | Ba. Inxhinieri Mekatronike | U rishikua në përshtatje me LAL 80/2015 | Vendim Senati datë 15.09.2017 |
| 5 | Ba. Inxhinieri Elektrike | U rishikua në përshtatje me LAL 80/2015 | Vendim Senati datë 15.09.2017 |
| 6 | MSc. Inxhinieri Elektronike | U rishikua në përshtatje me LAL 80/2015 | Vendim Senati datë 15.09.2017 |
| 7 | MSc. Teknologji Informacioni | U rishikua në përshtatje me LAL 80/2015 | Vendim Senati datë 15.09.2017 |
| **Departamenti i Arkitekturës** | | | |
| 1 | MSc. në Arkitekturë | n/a | n/a |
| 2 | Ba. në Dizajn | n/a | n/a |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQERORE**<br>**Departamenti i Shkencave Juridike** | | | |
| 1 | Bsc. Shkenca Juridike | Jo | |
| 2 | Mp. Shkenca Penale | Po | Vendim Nr. 16, datë 24.05.2017 |
| 3 | Mp. E Drejtë Private | Po | Vendim Nr. 16, datë 24.05.2017 |
| 4 | Msc. Shkenca Juridike (5profile) | Jo | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme** | | | |
| 1 | Bsc. Psikologji e Përgijthshme | Jo | |
| 2 | Mp. Psikologji Shkollore | Po | Vendim Nr. 16, datë 24.05.2017 |
| 3 | Mp. Psikologji Klinike | Po | Vendim Nr. 16, datë 24.05.2017 |
| 4 | Msc. Psikologji Klinike | Jo | |
| 5 | Msc. Psikologji Ligjore | Jo | |
| **Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative** | | | |
| 1 | Bsc. Shkenca Politiko -Administrative | Jo | |
| 2 | Mp. Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci | Po | Vendim Nr. 16, datë 24.05.2017 |
| 3 | Mp. Qeverisje dhe Administrim Publik | Po | Vendim Nr. 16, datë 24.05.2017 |
| 4 | Mp. Studime mbi Sigurinë | Po | Vendim Nr. 16, datë 24.05.2017 |
| **Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes** | | | |
| 1 | Bsc. Mësuesi për Arsimin Fillor | Po | Vendim nr. 19/1 Dt.02.12.2016 (Këshilli i Fakultetit të Shkencave Shoqërore) |
| 2 | Bsc. Mësuesi për Arsimin Parashkollor | Po | Vendim nr. 19/1 Dt.02.12.2016 (Këshilli i Fakultetit të Shkencave Shoqërore) |
| 3 | Bsc. Anglisht | Jo | |
| 4 | Mp. Pedagogji me profil "Didaktikë" dhe "Menaxim Arsimi" | Po | Vendim Nr. 16, datë 24.05.2017 |
| 5 | Msc. Mësuesi për Arsimin Fillor | Jo | |

## 2. Stafi akademik dhe vlerësimi i performancës

- Rekrutimi i stafit për vitin 2016-2017, nevojat për staf për vitin 2017-2018

| Rekrutimi për vitin akademik 2016-2017 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Profesorë | Profesorë të asociuar | Doktorë | Master i Shkencave |
| Fakulteti i Shkencave Mjekësore | 1 | 2 | 20 | 15 |
| Fakulteti i Shkencave Shoqërore | - | - | 2 | 1 |
| Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike | 1 | 4 | 12 | 6 |
| Totali | 2 | 6 | 34 | 22 |
| **Nevojat për vitin vitin e ardhshëm (2017-2018)** | | | | |
| Fakulteti i Shkencave Mjekësore | 9 | 15 | 21 | 0 |
| Fakulteti i Shkencave Shoqërore | - | 2 | 5 | 0 |
| Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike | 35 | | | 6 |
| Totali | 87 | | | 6 |

- Puna e pedagogëve e matur përmes raportit të vetëvlerësimit

Në përfundim të çdo semestri pedagogët plotësojnë raportin e vetëvlerësimit, i cili lidhet me ecurinë e programit mësimor, përqindjen e realizimit të objektivave mësimore, përqindjen e kalueshmërisë së studentëve për lëndën specifike si dhe propozime për përmirësime te mundshme në të ardhmen. Pedagogu e dorëzon në departamentin përkatës raportin e vetëvlerësimit, ku bëhet objekt analize dhe diskutimi. Kështu, pas analizave të bëra nga njësitë bazë ka rezultuar se për Fakultetin e Shkencave Mjekësore objektivat mësimore janë realizuar në masën 92.6%, për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike objektivat mësimore janë realizuar në masën mbi 80% dhe në Fakultetin e Shkencave Shoqërore objektivat mësimore janë realizuar mbi masën 90%.

- Puna e pedagogëve e matur përmes pyetësorëve të studentëve

Në Albanian University realizohen pyetësorë online me studentët dy herë në vit në fund të semestrit, përpara fillimit të sezonit të provimeve, duke ruajtur anonimatin e studentëve. Përveç tyre, në muajin dhjetor realizohen fokus – grupet me studentët. Qëllimi është që Universiteti të marrë një feedback dhe të dëgjojë zërin e studentëve për çështje të rëndësishme që lidhen me jetën e tyre universitare. Përgjithësisht, komentet e tyre kanë qenë pozitive, duke vënë theksin te stafi i kualifikuar i pedagogëve, te metodat bashkëkohore të mësimdhënies të përdorura nga pedagogët, korrektësia, etj.

- Puna e pedagogëve e matur nga drejtuesi i departamentit

Vlen të përmendet që pjesa më e madhe e stafit akademik në Albanian University është tashmë një staf i kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore dhe me një përvojë të gjatë në mësimdhënie. Puna e pedagogëve për vitin 2016-2017 ka qenë e një niveli të lartë. Impenjimi i tyre ka qenë maksimal dhe me përgjegjësi. Një gjë e tillë është reflektuar në raportet e vetëvlerësimit, te rezultatet e pyetësorëve të studentëve, rezultatet e fokus-grupeve, si dhe nga raporti i vlerësimit që drejtuesi i departamentit ka plotësuar për secilin pedagog, duke u nis nga çështja të tilla, si korrektësia administrative, formulari i veprimtarisë kërkimore - shkencore që secili pedagog dorëzon në departament, etj. Theksojmë, që duhen bërë më shumë përpjekje për përfshirjen e pedagogëve në projekte kërkimore shkencore.

## 3. Mësimdhënia dhe Studentët

- Informimi i studentëve

Është bërë praktikë tashmë që java e parë e fillimit të vitit akademik në Albanian University, është një javë orientuese për studentët. Në këtë periudhë studentët njihen më nga afër me çdo element të ardhshëm të jetës së tyre universitare, duke përfshirë stafin akademik dhe administrativ, ambientet ku do zhvillojnë mësimin, programet mësimore, të drejtat dhe detyrat e tyre, këshilli studentor, klubet studentore, zyrat përkatëse ku ato mund të drejtohen përgjatë gjithë vitit, organet kolegjiale ku ato mund të bëhen pjesë, etj. Ky informim realizohet nga Njësia bazë dhe gjithë stafi i tij akademik në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve.

- Zbatimi i kalendarit akademik, mbështetur në relacionet e pedagogëve për lëndën e tyre;

Kalendari akademik është zbatuar në masën mbi 80%. Gjatë semestrit të I-rë u zgjat periudha e pushimeve të dimrit me 1 (një) javë për shkak të kushteve atmosferike. Orët u rikuperuan sipas një kalendari të veçantë për secilin program.
Arsyet kryesore të mosrealizimit të orëve mësimore janë:
1. Festat zyrtare (sipas kalendarit akademik),
2. Mungesa e pedagogëve për arsye personale.

- Sigurimi i leksioneve dhe teksteve universitare në hardcopy dhe në rrugë elektronike, etj;

Në fillim të vitit akademik Njësia bazë në bashkëpunim me titullarët/lektorët e secilës lëndë bën të mundur rishikimin e literaturës që do të përdoret duke vënë theksin te përditësimi dhe pasurimi i saj me tekste bashkëkohore. Në secilën lëndë studentit i ofrohet literatura bazë, e cila gjendet në bibliotekën dhe në librarinë e Albanian University, literaturë e rekomanduar dhe përpos kësaj çdo pedagogë i lëndës mund të japi leksione shtesë të përgatitura nga vetë ai, të cilat gjendjen të depozituara pranë Njësisë Bazë dhe i mundësohen studentit edhe në formë elektronike.

- Kalueshmëria dhe nota mesatare e studentëve

Në rang universiteti, kalueshmëria e studentëve për të gjitha ciklet dhe programet e studimit, rezulton mbi 85%. Nota mesatare për studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore rezulton 7.7, për studentët e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike 7, ndërsa për studentët e Fakultetit të Shkencave Shoqërore 7.5.

## 4. Infrastruktura

- Mjediset ku zhvillohen leksionet, praktikat, salla e kompjuterëve, laboratorët, etj.

| GODINA | Sipërfaqe $m^2$ | Nr. Lab | Nr. Klasa seminare (Kapaciteti në vende) | Nr. Klasa leksione, auditore (Kapaciteti ne vende) |
|---|---|---|---|---|
| 1. Bulevardi Zogu I - Ish Estrada (Fakulteti i Shkencave Shoqërore + Departamenti i Ekonomikut) | 3996 | 1 | 12 | 8 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2. Rruga e Durrësit - Ish Gjykata (Fakulteti i Shkencave Mjekësore) | 2267.4 | 9 | 3 | 2 |
| 3. Rruga K. Karafili - Internacionali (Fakulteti i Shkencave Mjekësore) | 1834.69 | 15 | 1 | 4 |
| 4. Rruga e Kavajës - Raiffeisen (Fakulteti i Shkencave Mjekësore + Inxhinieri) | 445 | n/a | 5 | n/a |
| 5. Godina në Rrugën e Elbasanit (ish Universitetit Amerikan të Tiranës) | 10,000 | 18 | 26 | 23 |
| 6. Rruga e Kavajës - Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (Departamenti i Arkitekturës dhe Inxhinierive) | 1901.69 | 9 | 8 | 5 |
| Sipwrfaqja totale në $m^2$ | 20,445 | | | |

**Lista e laboratorëve**

**Fakulteti i Shkencave Mjekësore**

- Klinika Universitare

Klinika Universitare, me vendndodhje në godinën e Ish-Gjykatës, është pjesë e rëndësishme në ndihmë të Departamentit të Stomatologjisë, me nënndarjen:

- në salla të praktikës paraklinike (2 laboratorë me afërsisht 50 vende pune) ku aplikohen punimet dentare në pupac (kukulla-model),
- dhe në 6 salla klinike dhe 1 sallë filtri, ku kryhen punimet klinike nga ana e studentëve.( me 77 unite dentare)

Klinika Universitare mbështet funksionimin e Departamentit, me sallat e mirë-profilizuara si: salla e terapisë (dentisteri e endodonti), e pedodontisë për trajtimin e moshave 3-16 vjeçare; ajo e ortodontisë; e protetikës fikse e të lëvizëshme së bashku me laboratorin e studentëve; salla e kirurgjisë ambulatore; salla e periodontologjisë dhe e sëmundjeve të mukozave, si dhe një repart imazherie. Së fundmi i është bashkëngjitur dhe Day Hospital, salla e kirurgjisë me hospitalizim 24 orësh.

Secila sallë ka specifikat e veta për lëndën që mbulon. Si rrjedhojë, edhe materialet mbështetëse për realizimin e punimeve klinike janë specifike, sipas karakteristikave të çdo salle. Krahas këtyre sallave ekziston edhe salla e ekzaminimit radiografik dixhital, që është në ndihmë të studentëve për vlerësimin dhe ekzaminimin e rasteve klinike. Vlen për tu përmendur investimi që është bërë për programin kompjuterik të vlerësimit cefalometrik dhe aparatit fotografik profesional, që i vijnë në ndihmë studentëve për vlerësimin, diskutimin, trajtimin e rasteve klinike në fushën e Ortodontisë. Për realizimin në kushte sa më optimale të ndërhyrjeve

kirurgjikale ambulatore janë vënë në dispozicion dy salla kirurgjikale që përmbushin kriteret e nevojshme për kryerjen në kushte sterile të ndërhyrjeve. Sallat janë të pajisura me paradhomë me shtretër për ekzaminimin klinik të përgjithshëm korrekt të pacientit, gjetjen e rrugëve venoze nëse ndërhyrja do kryhet me sedacion dhe hospitalizimin disa orë pas interventit deri në largimin e tij në kushte optimale pas ndërhyrjes. Salla lavazhi për mjekët për te garantuar asepsinë e ndërhyrjes e pajisur me lavaman dhe solucione e veshje sterile. Salla e sterilizimit me autoklave, letër plastifikimi për mjetet kirurgjikale të cilat sterilizohen dhe ruhen në kushte sterile,çistela etj.

Studentët punojnë në ekip me katër duar mbi pacientin e caktuar, ku njëri luan rolin e doktorit dhe tjetri të asistentit. Materialet për çdo sallë janë specifike ku përgjegjës është asistenti i sallës, që ndihmon në dhënien e instrumentave, materialeve të kërkuara nga studenti, pas miratimit të pedagogut. Çdo sallë është e pajisur edhe me një ordinator dhe një asistent pedagog, që janë të profilizuar specifikisht sipas orientimit të sallës dhe janë të aftë të mbajnë frontin e punës.
Mjediset laboratorike shfrytëzohen jo vetëm për aktivitetin mësimor, por dhe punë kërkimore shkencore nga ana e pedagogëve dhe studentëve të cilët punojnë për temën e diplomës dhe punimet që prezantojnë në konferencat studentore.

- Laboratori i Kimisë Analitike 1
- Laboratori i Kimisë Analitike 2
- Laboratori i Teknologjisë Farmaceutike
- Laboratori i Kimisë së Përgjithshme Inorganike
- Laboratori i Kimisë Farmaceutike
- Laboratori i Farmakognozisë
- Preparatori i Teknologjisë Farmaceutike dhe Farmakognozisë
- Preparatori i Kimisë Farmaceutike, Kimisë Toksikologjike dhe Metodat Instrumentale të Analizës
- Dhoma e Aparaturave
- Laboratori i Kimisë Toksikologjike dhe Metodat Instrumentale të Analizës
- Laboratori i Anatomisë I
- Laboratori i Anatomisë II
- Laboratori i Fizikës
- Laboratori i Praktikës Paraklinike 1
- Laboratori i Praktikës Paraklinike 2
- Laboratori i Protetikës
- Laboratori i Infermierisë

- Laboratori i Fizioterapisë

## Fakulteti i Shkencave Shoqërore

- Laboratoti i Edukimit figurativ
- Laboratori i Informatikës
- Laboratori i Edukimit muzikor

## Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike

- Laboratorët e Informatikës 1 – 2 (Simulimeve)
- Laboratori i Fizikës
- Laboratori i Kimisë
- Laboratori i Elektroteknikës
- Laboratori i elektronikës analoge\laboratori i elektronikës dixhitale
- Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike
- Laboratori i automatikës dhe kontrollit *(dhe Mekatronikës)*
- Laboratori i makinave elektrike

➢ Biblioteka – gjendja aktuale, pasurimi me tekste të reja, nevojat për vitin e ardhshëm

| Fakulteti | Totali i teksteve në gjendje | Hyrja e teksteve të reja për 2016-2017 | Nevojat për vitin 2017-2018 | Libraritë ONLINE |
|---|---|---|---|---|
| Fakulteti i Shkencave Mjekësore | 341 | 79 | 26 | • ELSEVIER<br>• QUESTIA<br>• CAMBRiDGE JOURNALS(www.cambridge.org/core)<br>• ERIC(Education Resource Information Center) |
| Fakulteti i Shkencave Shoqërore | 1156 | 15 | 60 | • QUESTIA<br>• CAMBRiDGE JOURNALS(www.cambridge.org/core)<br>• ERIC(Education Resource Information Center) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike | 616 | 56 | 169 | • GETTY<br>• QUESTIA<br>• CAMBRIDGE JOURNALS(www.cambridge.org/core)<br>• ERIC(Education Resource Information Center) |

## 5. Financimi

- Financimi i veprimtarive shkencore dhe kualifikimeve të stafit;

Burimet financiare dhe përdorimi i tyre në AU bëhet në bazë të një programi financiar, afat-mesëm 3-vjeçar, i hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara në Ligjin Nr.80/2015 Për Arsimin e Lartë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në Ligjin Nr.9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre. Programi financiar miratohet nga Bordi Administrativ pasi hartohet nga Rektorati si dhe pasi është bërë objekt diskutimi në Senat akademik. Departamentet e AU-së mbështeten financiarisht në mënyrë transparente dhe të hapur nga Bordi Administrativ, i cili me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.

## 6. Kërkimi shkencor

- Veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit nga Institucioni si konferenca, workshop, tryeza të rrumbullakëta, leksione të hapura, etj.

Albanian University si çdo vit akademik, edhe për vitin 2016-2017 ka realizuar një sërë aktivitetesh shkencore, të cilat janë të listuara të tabela e mëposhtme.

| **Veprimtaritë e zhvilluara nga Institucioni** | | |
|---|---|---|
| Konferenca | Leksione të hapura | Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, Trajnime, etj) |
| **09.12.2016**<br>"Problemet dhe Sfidat e Transformimit të Shoqërisë Shqiptare Drejt Standardeve të Bashkimit Europian"<br><br>**07.04.2017** | **24.11.2016**<br>"Çfarë është Erasmus + dhe si të bëhemi pjesë?"<br><br>**13.04.2017**<br>"Roli i Zyrës së të Drejtës së Autorit në | **22.12.2016**<br>Open Day<br>Kujdesi Oral tek femijët<br><br>**04.02.2017**<br>Trajnim per lazer dhe demostrim paraklinik |

| | | |
|---|---|---|
| Konferenca e 13-t Ndërkombetare Stomatologjike "Advances in Dentistry and Oral Health"<br><br>**21-23/04/2017**<br>Konferenca Kombetare e Mjekesise Dentare IV<br><br>**12-13 Maj 2017**<br>“Qasjet e fundit shkencore dhe zhvillimet në Shkencat Farmaceutike”<br><br>**21-22.04.2017**<br>“Shkencat Mjekësore Klinike dhe Kirurgjikale”<br><br>**28.03.2017**<br>Konferencë informimi për punësim në Gjermani- E-LINGUA<br><br>**19.04.2017**<br>Konferencë informimi për punësim në Gjermani- E-LINGUA | Republikën e Shqipërisë në zbatimin e legjislacionit përkatës”<br><br>**15.11. 2016**<br>Pjesëmarrja ne Demokraci, zgjedhjet dhe raporti me te zgjedhurit", Z. Frank Hantke,<br><br>**10.02.2017**<br>“Shkrimi Akademik dhe rendesia e tij ne kerkimin shkencor”<br><br>**1.04.2017**<br>“Parandalimi sekondar në Fizioterapi, roli i fizioterapistit ne depistimin e pacientëve në moshën pediatrike”<br><br>**12.04.2017**<br>“Ndihma e parë e pacientit në arrest kardiak” | **16-17-18/02/2017**<br>Corso practico di chirurgia implantare su paziente<br><br>**24-25-26/05/2017**<br>“TAIEX Expert Mission on Building Mechanisms for Better Participation in Horizon 2020”<br><br>**27/05/2017**<br>Takimi i IV i ortodonteve Shqiptare<br><br>**14.04.2017**<br>"Aplikimi i metodave kromatografike në farmaceutikë"<br><br>**26.05.2017**<br>"Përdorimi i teknologjisë në zbulimin e evazionit fiskal " |

- Veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit nga pedagogët si konferenca, projekte, publikime, etj.

| Veprimtaritë e zhvilluara nga pedagogët | | | |
|---|---|---|---|
| Konferenca | Publikime në revista shkencore | Leksione të hapura | Tjetër (si projekte, etj) |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE** | | | |
| 120 | 102 | 11 | 24 |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE** | | | |
| 56 | 64 | 16 | 5 |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE EKONOMIKE** | | | |
| 127 | 137 | 8 | 8 |

- Veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit nga studentët si konferenca studentore, aktivitete ekstrakurrikulare, etj.

| Veprimtaritë e zhvilluara nga studentët | | |
|---|---|---|
| Konferenca studentore | Aktivitete ekstrakurrikulare | Tjetër |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE** | | |
| ***24 Mars 2017*** Konferencë Studentore me temë "Kërkimi Shkencor në Këndvështrimin Studentor"<br><br>***23.Mars 2017***<br><br>Konferenca e 11-të Studentore Stomatologjike | ***11 - 12 Nëntor 2016*** -Olimpiada Sportive "Universiada Tirana 2016";<br><br>***13 Nëntor 2016***– Pastrimi i qytetit te Tiranës;<br><br>***20 Dhjetor 2016*** –<br>Studentët e AU ne bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, dhurojnë pako për fëmijët jetim të qytetit | **15 Nëntor 2016** –<br>Takim informues Çfarë është Erasmus + dhe si të bëhemi pjesë?<br><br>***03 Dhjetor 2016*** –<br>Leksion i hapur: "Aftësitë e komunikimit dhe shkrimi në gjuhën shqipe<br><br>***15.Shtator 2017*** |

| | | |
|---|---|---|
| "Shendeti oral ne fokus te Stomatologjisë" | të Tiranës<br><br>***22 Shkurt 2017*** – Vizitë në Ambasadën Amerikane - Takim me ambasadorin Donald Lu, Tema: "Të rinjtë dhe punësimi"; | *Takimi i I i Specializantëve* të Ortodoncisë, në kuadrin e edukimit në vazhdim.“NEË TECHNICS AND DEVELOPMENT IN THE FIELD OF ORTHODONTIC” |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE** | | |
| 29 Maj 2017;<br>Konferenca studentore me temë “Aspektet psiko-pedagogjike të mësimdhënies”<br><br>**31.05.2017**<br>“Konsolidimi i Shtetit të së Drejtës: Nevoja për reforma dhe domosdoshmëria për implementim”<br><br>**Maj 2017**<br>Metodat interaktive në mësimdhënie” | **27 Prill 2017;**<br>Leksion i hapur me temë **“**Elektrosmogu dhe ndikimi i tij në shëndetin mjedisor dhe mendor**”** | **1 Qershor 2017;**<br><br>Simpozium me temë “Abuzimi me substancat, parandalimi dhe trajtimi”, në ditën botërore kundër duhanit.<br><br>**2 Qershor 2017;**<br>Seminar Shkencor me temë “Çrregullimet e ankthit, format e shfaqjes tek fëmijët dhe të rriturit, ndërhyrjet terapeutike”. |
| **FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE EKONOMIKE** | | |
| **Konferencë Studentore me temë**: "Zhvillimi i Qëndrueshëm"<br>**Data:** 26.05.2017 | Aktivitet social – Dhurata për shtresat në nevojë me rastin e festave të fund vitit - **24.12.2016.**<br><br>Orientim i studentëve mbi mundësitë e punësimit të ofruara nga Agjencia e Punësimit "DrPendl & Dr.Piswanger" – **19.01.2017.**<br><br>Vizitë në Ambasadën Amerikane - Takim me ambasadorin Donald Lu, Tema: "Të rinjtë dhe punësimi" – **22.02.2017.** | |

| | | |
|---|---|---|
| | Trajnim mbi “Çrregullimet e të ngrënit te fëmijët dhe adoleshentët - Njohja me problematikën, rastet dhe implementimi i protokollit PEI me praninë e specialistëve të mjekësisë, psikologjisë, punonjësit social etj. – **06.04.2017.**<br><br>Panairi i Karrierës – **29.06.2017.**<br><br>**21-22 prill 2017 Ekskursion studimor:** "Njohja e bregdetit jonian dhe zhvillimi i jugut", organizuar nga departamenti i Arkitekturës, “Albanian University”.<br><br>**Tavolinë e Rrumbullakët** me temë: "Informatika e aplikuar në metoda e kërkimit sasior dhe statistikë"<br>**Data:** 17.03.2017.<br><br>**Tavolinë e Rrumbullakët** me temë: "Financimi i projekteve në ndërmarrjet prodhuese"<br>**Data:** 21.04.2017.<br><br>**Simpozium** me temë “Struktura optimale e kapitalit në bizneset e hapësirës shqiptare në Ballkan”<br>**Data:** 27.01.2017.<br><br>**Simpozium** me temë “Impakti i liberalizimit të tregjeve të Ballkanit në konkurrencën dhe rritjen ekonomike të Shqipërisë”<br>**Data:** 24.02.2017 | |

| | | |
|---|---|---|
| | **Simpozium me temë** "Risku i ekonomisë shqiptare krahasuar me rajonin"<br>**Data:** 20.01.2017. | |

**7. Bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit**

- Marrëveshjet e firmosura me partner të ndryshëm, si dhe për çfarë i shërbejnë Universitetit.

  Albanian University ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete kombëtare dhe ndërkombëtare, organizata të ndryshme, institucione publike dhe jopublike me qëllim realizimin e aktiviteteve kërkimore shkencore të përbashkëta, mobilitetin e stafit dhe studentëve, realizimin e praktikave mësimore, etj.

| Marrëveshjet e vlefshme për vitin akademik 2016-2017 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Numri | Institucioni | Qëllimi i marrëveshjes | Viti i nënshkrimit të marrëveshjes | Kohëzgjatja e marrëveshjes |
| **1** | Instituti i Statistikave | Kërkim shkencor | Shkurt 2012 | pa afat |
| **2** | Qendra Studimore Universitare, Tiranë | Kërkim shkencor | 2 Mars 2012 | pa afat |
| **3** | Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave | Kërkim shkencor | 2 Mars 2012 | pa afat |
| **4** | Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë | Kërkim shkencor, Organizimin e eventeve te përbashkët shkencore | 25 Maj 2015 | Çdo vit nënshkruhen Aneks Kontrata për bashkëpunime konkrete |
| **5** | Instituti i Shëndetit Publik | Kërkim shkencor, mbështetje laboratorike për realizim i temave doktorate | 29 Shkurt 2012 | pa afat |
| **6** | Fakultetin e Mjekësisë, Bucharest, Romania | Kërkim shkencor, mbështetje laboratorike për realizim i temave doktorate | | 6 vite |
| **7** | SUOGJ " Mbretëresha Geraldinë" (Qendra e diagnostikës Molekulare) | Kërkim shkencor, mbështetje laboratorike për realizimin e temave doktorate - | 11 Janar 2017 | pa afat |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **8** | Universiteti i Pizës, Itali | Kërkim shkencor. Shkëmbim i stafit akademik | Qershor 2011 | pa afat |
| **9** | Universiteti i Palermos, Itali | Shkëmbim i stafit akademik | Shkurt 2011 | pa afat |
| **10** | Universiteti i Napolit, Itali | Shkëmbim i stafit akademik | 27.01.2017 | 5 vite |
| **11** | Universiteti i Aquilas, Itali | Shkëmbimin e stafeve akademike, personelit kërkues shkencor dhe studentëve;<br>Shkëmbim të publikimeve, materialeve shkencore, projekteve kërkuese; Zhvillimin e projekteve kërkimore. | 27 mars 2015 | 6 vjet |
| **12** | Universiteti i Padovës, Itali | Shkëmbim Personeli; Projekte kërkimi të përbashkëta; Dhurime Librash; Mundësimi i Doktoraturës për stafin e AU | 29 Janar 2016 | 3 vjet |
| **13** | Universiteti Sigmund Freud, Vienë | Kërkim shkencor. Shkëmbim i stafit akademik | Qershor 2015 | n/a |
| **14** | Fondin e sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit shëndetësor | | 27.Tetor 2016 | n/a |
| **15** | Rrjeti i Universiteteve "Mediterranean and Middle East Network Agreement (MUNA), Federico II, Napoli, Itali | 1. Bashkëpunim në fushën e arsimit (para dhe pas diplomimit).<br>2. Kërkime multicentrike.<br>3.Krijimin e mundësive të përshtatshme për Universitetet pjesëmarrëse, në bazë të specifikave të tyre. | Qershor 2015 | 5 vite |
| **16** | Spitali Universitar i Traumës | Bashkëpunim institucional(ku përfshihen dhe praktikat e studenteve) | 2016 | pa afat |
| **17** | SUOGJ "Koco Gliozheni" | Bashkëpunim institucional(ku përfshihen dhe praktikat e studenteve) | 2016 | pa afat |
| **18** | Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi", Tirane | Bashkëpunim institucional (ku përfshihen dhe praktikat e studenteve) | 2016 | pa afat |
| **19** | Agjensia e shërbimit të | Bashkëpunim | 2016 | pa afat |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Sportit | institucional(ku përfshihen dhe praktikat e studenteve) | | |
| **20** | Klinika Mjekësore Halili | Praktika profesionale e studenteve | 2017 | Pa afat |
| **21** | Qendra Sociale Edukative Primavera | Praktika profesionale e studenteve | 2017 | Pa afat |
| **22** | Qendra e rehabilitimit te fizoterapise “Balance” | Praktika profesionale e studenteve | 2017 | Pa afat |
| **23** | A. E. Distribution | Praktika mësimore | 08.03.2016 | pa afat |
| **24** | ComputerCopyCentersh.p.k. | Praktika mësimore | 03.12.2014 | pa afat |
| **25** | Birra Tirana | Praktika mësimore | 29.02.2016 | pa afat |
| **26** | XpertSystemssh.p.k. | Praktika mësimore | 05.01.2016 | pa afat |
| **27** | EngineeringGroupsh.p.k. | Praktika mësimore | 09.09.2016 | pa afat |
| **28** | IN2 - Albania | Praktika mësimore | 06.10.2016 | pa afat |
| **29** | Sinteza CO | Praktika mësimore | 06.10.2016 | pa afat |
| **30** | Universal Office | Praktika mësimore | 16.09.2016 | pa afat |
| **31** | ForschnerAlbaniash.p.k | Praktika mësimore | 04.04.2017 | pa afat |
| **32** | Xhenluxsh.p.k | Praktika mësimore | 25.04.2017 | pa afat |
| **33** | Dajti Express sh.p.k. | Praktika mësimore | 16.05.2017 | pa afat |
| **34** | ITES | Praktika mësimore | 15.05.2017 | pa afat |
| **35** | Bregu sh.a. | Praktika mësimore | 19.05.2017 | pa afat |
| **36** | ELAL COM | Praktika mësimore | 25.05.2017 | pa afat |
| **37** | NingboDahongyingUniversity | Shkëmbime studentë, staf etj. | 2016 | 2019 |
| **38** | PoëislanskiCollege | Shkëmbime studentë, staf etj. | 2017 | 2021 |
| **39** | IKAZH | Partneritet në Projekte | 2016 | Papërcaktuar |
| **40** | Angel KanchevUniversity | Shkëmbime studentë, staf etj. | 2016 | 2021 |
| **41** | Kolegji "AAB", Kosove | Shkëmbim të kapaciteteve dhe njohurive teknike; Shkëmbim Personeli | 2016 | Papërcaktuar |
| **42** | Kolegji "PjeterBudi" | Shkëmbim Personeli | 2016 | Papërcaktuar |
| **43** | Kolegji "UBT" | Shkëmbim Personeli | 2016 | Papërcaktuar |
| **44** | Universiteti Politeknik i Tiranes | Shkëmbim Personeli | 2016 | Papërcaktuar |
| **45** | Universiteti "Neofit Rilski" - Bullgari | Shkëmbim Personeli | 2016 | Papërcaktuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **46** | Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit | Shkëmbim të informacionit shkencor; Shkëmbimin e materialit dokumentar; Zbatimin e projekteve të përbashkëta kërkimore; Organizimi i seminareve, ekspozitave; Bashkëpunim në botime | 2016 | Papërcaktuar |
| **47** | Arkivi i Shtetit Shqiptar | Shkëmbim të informacionit shkencor; Shkëmbimin e materialit dokumentar; Zbatimin e projekteve të përbashkëta kërkimore; Organizimi i kurseve, seminareve, praktikave | 2016 | Papërcaktuar |
| **48** | Instituti i Monumenteve të Kulturës "GANI STRAZIMIRI"; | Shkëmbim të informacionit shkencor; Shkëmbimin e materialit dokumentar; Zbatimin e projekteve të përbashkëta kërkimore; Bashkëpunimin në botime | 2016 | Papërcaktuar |
| **49** | Studio projektimi "Arkimade" | Praktikë profesionale | 2016 | Papërcaktuar |
| **50** | Delta Group | Praktikë profesionale | 2016 | Papërcaktuar |
| **51** | H&S Project | Praktikë profesionale | 2016 | Papërcaktuar |
| **52** | Studio projektimi "SON-Group" | Praktikë profesionale | 2016 | Papërcaktuar |
| **53** | Studio projektimi "Pëllumb Dervishaj" | Praktikë profesionale | 2016 | Papërcaktuar |
| **54** | Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda | Praktikë profesionale | 13.01.2012 | Pa afat |
| **55** | Gjyakata e Rrethit Gjyqësor Tiranë | Praktikë profesionale | 13.01.2012 | Pa afat |
| **56** | Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë | Praktikë profesionale | 21.05.2015 | Pa afat |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **57** | Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit | Praktikë profesionale | 07.02.2014 | Pa afat |
| **58** | Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë | Praktikë profesionale | 15.11.2011 | Pa afat |
| **59** | Ministria e Drejtësisë | Praktikë profesionale | 24.02.2012 | Pa afat |
| **60** | Studio Ligjore “Lama & Associates” | Praktikë profesionale | 15.01.2012 | Pa afat |
| **61** | Studio Ligjore “Bozo & Associates” | Praktikë profesionale | 12.01.2012 | Pa afat |
| **62** | Qëndra për Nisma Ligjore Qytetare | Praktikë profesionale | 13.01.2012 | Pa afat |
| **63** | Shërbimi i Provës, Zyra Vendore Berat | Praktikë profesionale | 14.11.2013 | Pa afat |
| **64** | Departamenti i Administratës Publike (DAP) | Praktikë profesionale | 25/01/2012 | Pa afat |
| **65** | Komuniteti i biznesit, tregu i punës (DELTA- Kompani) | Praktikë profesionale | | Pa afat |
| **66** | “Instituti i Studimeve Politike” | Praktikë profesionale | 10.03.2016 | Pa afat |
| **67** | Bashkia Tiranë | Për praktikat mësimore dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta | 8.02.2017 | Pa afat |
| **68** | Qendra Private e Zhvillimit "Shtëpia e Kuqe" | Për praktikat mësimore | 15.03.2015 | Pa afat |
| **69** | Aksion + | Për praktikat mësimore | 20.01.2012 | Pa afat |
| **70** | Autoriteti Shëndetësor Rajonal | Për praktikat mësimore | 14.02.2014 | Pa afat |
| **71** | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve te Shqipërisë | Për praktikat mësimore | 05.05.2015 | Pa afat |
| **72** | Fondacioni Fëmijët Shqiptarë | Për praktikat mësimore dhe zhvillimin e projekteve të | 16.03.2015 | Pa afat |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | përbashkëta | | |
| **73** | Klinika e Shëndetit Mendor Venis | Për praktikat mësimore | 24.01.2012 | Pa afat |
| **74** | Kryqi i Kuq Shqiptar | Për zhvillimin e projekteve të përbashkëta | 05.12.2014 | Pa afat |
| **75** | Drejtoria Arsimore Rajonale, Durrës | Për praktikat mësimore | 01.04.2015 | Pa afat |
| **76** | Qendra “Lira”, Berat | Për praktikat mësimore | 5.05.2016 | Pa afat |
| **77** | Drejtoria Arsimore Rajonale, Berat | Për praktikat mësimore | 5.05.2015 | Pa afat |

## 8. Aplikimi në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare

| | INSTITUCIONI I HUAJ | PARTNERI LOKAL | THIRRJA / PROJEKTI/PROGRAMI | STATUSI | DATA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bullgari | | Po<br>Student Festival of Arts, Erasmus | Aplikim | FSHAE-Arkitektura & Design |
| **2** | Federico II Napoli I | | KA1 - Erasmus+ | Aplikim i Përfunduar | Shkurt 2 |
| 3 | Powislanski College - Poloni | | Erasmus+ KA1 | Po lëvizet drejt rekrutimit te studentëve | 2017-2018 |
| **4** | | Universiteti Bujqësor i Tiranës | KA2 - Erasmus+ | Aplikim i Përfunduar | Java I - Shkurt |
| **5** | Universita degli studi di Salerno | | Erasmus+ KA1 | Aplikim i Përfunduar | Shkurt 2/9 |
| 6 | Universita di Pisa | | Erasmus+ KA1 / Bashke-Konferenca | Përgatitje Aplikimi për vitin tjetër akademik | Në zhvillim |
| 7 | Universiteti I Firences | | Erasmus+ / Etj. | Dërguar Memorandum Bashkëpunim | Në pritje |
| 8 | Universiteti i Pavodës | | Erasmus+ KA1/ Etj. | Pritet përgjigje nga koleget për vitin e ri akademik | Jo definuar |
| 9 | La Sapienza - (Rome) | Instituti i Shëndetit Publik | Të Ndryshme | Memorandum Bashkëpunimi | Jo definuar |
| 10 | Università Cattolica del Sacro Cuore | Instituti i Shëndetit Publik | Të Ndryshme | Memorandum Bashkëpunimi | Marrëveshja në Zhvillim |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | (Rome) | | | | |
| 11 | Universida de Vigo | | Erasmus+ KA2 - Green Tech Western Balkans | Dokumentacioni i plotësuar dhe dërguar - ne pritje te thirrjes nga Spanja | Jo definuar |
| 12 | Instituto Superiore di Sanita - Colomed | | Colomed - Colorectal Cancer | Anëtar i rrjetit Colomed - Po përgatiten broshurat dhe prezantimi I AU-se ne konferencat ndërkombëtare | Pa limit ne kohe |
| 13 | University "Angel Knachev" Ruse, Bulgaria | | Cooperation Agreement | Firmosur | Ne zhvillim |
| 14 | Varna University of Management | | Cooperation Agreement - Ftese për summer school dhe Erasmus+ | Firmosur | Ne zhvillim |
| 15 | Akademia e Shkencave të Austrise | AKKSH-i | Marie Curie - Horizon 2020 - Post Doc | Aplikime Individuale | Ne zhvillim |
| 16 | Engineering & Tech Entrepreneurship Center (ETEC) | Bashkia Tirane, Mulliri i Vjetër, etj | Iniciative Personale | Po hulumtohen dhe ndertohen propozime per projekte | Stafi Pedagogjik & Studentë të përfshire në mbledhje dhe trajtim propozimesh |
| 17 | Universita di Palermo | | Bashkëpunim në Shkëmbime | I rinovuar | Ne Zhvillim |
| 18 | Tethys Consortium | | Bashkëpunim në Shkëmbime | Po përgatiten dokumentet e Bashkëpunimit | Ne zhvillim |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 19 | Euraxess - The European Charter for Researchers | | Anëtar - Aderim ne standardet EU të kërkimit shkencor | Marrëveshje Bashkëpunimi & Pjesëmarrjeje | Në implementim - Faza I |
| 20 | Korniza Shqiptare e Kualifikime | | Anetar - Korniza e Binjakëzimit të Kurrikulave | Marrëveshje Bashkëpunimi & Pjesëmarrjeje | Në implementim - Faza I |
| 21 | CORDIS Europa | | EU Research Community & Development Community | Duke plotësuar profilin Akademik (AU) dhe Operacional (AU Center) | Në Zhvillimet e para |
| 22 | AUSTRIA<br>Sigmund Freud Wien | | Erasmus | FSHSH - Psikologjia | Po |

## 9. Analiza SWOT

**a. Pika të forta:**

1. Struktura organizative e "Albanian University" funksionon në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe aktet nënligjore në fuqi.
2. Staf akademik i kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë.
3. Albanian University ofron programe studimi në të tre ciklet e studimit: Bachelor, Master, specializime pasuniversitare dhe Doktoratë.
4. Kurrikulat janë bashkëkohore, në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend dhe bazuar në literaturë të viteve të fundit.
5. Institucioni është i pozicionuar në qendër të qytetit dhe ofron mjedis dhe infrastrukturë nxitëse për zhvillimin e programeve të studimit
6. "AU" ka hartuar strategji për Zhvillimin Institucional mbështetur në marrëveshje bashkëpunimi mjaft operacionale me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit
7. Dokumentacioni dhe mekanizmat e komunikimit janë të mirë zhvilluara. Institucioni ndjek politika të transparencës me stafin akademik, studentët ashtu dhe me publikun e gjerë.
8. Albanian University ofron struktura mbështetëse dhe ndihmëse për studentët duke i përfshirë në proceset vendimmarrëse me qëllim përmbushjen më të mirë të nevojave të tyre
9. Shtëpia botuese AU Press përkthen dhe publikon literaturë bashkëkohore në ndihmë të procesit mësimor, si dhe mbështet publikimin e revistës shkencore, punime të konferencave, projekteve si dhe punime dhe tekste individuale të pedagogëve.
10. Burimet financiare të institucionit paraqiten të mjaftueshme për qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë në të ardhmen

**b. Pika të dobëta (ose pikat ku ka vend për përmirësim):**

1. Përthithja e projekteve dhe zgjerimi i partneriteteve me institucione të huaja të arsimit të lartë në kuadër të mobilitet të stafit akademik dhe studentëve.
2. Përshtatja e insfrastrukturës për studentët me nevoja të veçanta

**c. Mundësitë:**

1. Nëpërmjet pjesëmarrjes në programet e Erasmus +, AU ka mundësi të përthithë projekte dhe të zgjerojë mundësitë e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve
2. Ndërtimi i një kampusi bashkëkohor në qendër të Tiranës

**d. Pengesat:**

1. Angazhimi më i madh i strukturave të "AU" për futjen në hapësirat e sistemit evropian do të mund të kapërcejë problematikat në lidhje me bashkëpunimin me institucione të huaja dhe projekte rajonale dhe ndërkombëtare.
2. Ndërtimi i kampusit ka si pengesë kohën që duhet në dispozicion për realizimin e procedurave të marrjes së lejes dhe vendimmarrjes së pushtetit vendore.